

RECENSION

PËR VLERËSIMIN E TE TËZËS SË DOKTORATURËS TË KANDIDATES,
ZNJ. DARDANE BOJAXHI

NË PROGRAMIN STUDIMOR GJUHË DHE LETËRSI GJERMANE TË
FAKULTETIT FILOLOGJIK, UNIVERSITETI I TETOVËS

Deri te:

KËSHILLI MËSIMOR-SHKENCOR I FAKULTETIT FILOLOGJIK

Në bazë të vendimit të Këshillit mësimor-shkencor të Fakultetit Filologjik, në mbështetje të nenit 62 të Rregullores për kushtet, kriteret dhe rregullat e regjistrimit dhe studimit në ciklin e tretë të studimeve – studimet e doktoraturës në Universitetin e Tetovës, në mbledhjen e Këshillit mësimor-shkencor të Fakultetit Filologjik, të mbajtur më datë 13.11.2023, me nr. 18-646/3, të protokolluar në Arkivin e Fakultetit Filologjik më datë 21.11.2023, është sjellë vendim për formimin e komisionit vlerësues të tezës së doktoraturës së kandidates znj. Dardane Bojaxhi në programin studimor: Gjuhë dhe letërsi gjermane, në përbërje:

1. Prof. Dr. Gjuliano Iseini – kryetar
2. Prof. Dr. Majlinda Nuhiu – anëtar
3. Prof. Dr. Arbër Çeliku - anëtar
4. Prof. Dr. Berton Sulejmani - anëtar
5. Prof. Dr. Shadan Ramadani – anëtar

Komisioni vlerësues, duke qenë falënderues për besimin e dhënë, ka nderin të paraqesë këtë:

R A P O R T

për vlerësimin e tezës së doktoraturës së kandidates Dardane Bojaxhi me temë:
Kolokacionet në gjuhën gjermane dhe shqipe – analizë kontrastive

Të dhëna biografike dhe arsimimi:

Kandidatja Dardane është lindur më 03.07.1990 në Prizren, Republika e Kosovës.

Shkollimin fillor dhe të mesëm i ka kryer në Prizren, kurse studimet për gjuhë dhe letërsi gjermane në Universitetin e Prishtinës në vitin 2012. Ka magjistruar në Universitetin e Tiranës për gjuhë dhe letërsi gjermane në vitin 2014.

Me hapjen e studimeve të doktoraturës për herë të parë në Universitetin e Tetovës në vitin akademik 2015/16 ajo, duke marrë parasysh interesin dhe dëshirën e zjarrtë për thellimin e njohurive të saj në fushën e gjuhësisë gjermane, regjistrohet në studimet e doktoraturës në programin studimor Gjuhë dhe letërsi gjermane, i vetmi program i akredituar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës së RM-së, sot RMV dhe, në konsultim me mentorin e akredituar, Prof. Dr. Arbër Çeliku, përzgjedh temën: *Kolokacionet në gjuhën gjermane dhe shqipe – analizë kontrastive*

Gjatë dy semestrave të parë ajo i ka dhënë me sukses të gjitha provimet, e para me Rregulloren dhe Programin e akredituar të shkollës doktorale me sukses të shkëlqyeshëm.

Po ashtu me sukses i ka përmbyllur të tria konferencat doktorale, të parapara me Rregulloren e studimeve të doktoraturës.

Ka publikuar këto punime shkencore ndërkombëtare:

- Dardane Bojaxhi, Naim Berisha: “Ndikimi i anglishtes dhe i gjermanishtes në gjuhën shqipe, natyra e huazimeve gjuhësore në të folurit e përditshëm”, Konferenca shkencore në Universitetin e Prizrenit, Maj 2016.

- Dardane Bojaxhi, Nebi Caka: "Gjermanizmat në shqipen e folur në Kosovë", *Albanologjia*, Vol.3 No.5-6, Tetovë 2016
- Dardane Bojaxhi "The problematique of collocations in the papers of Albanian students of German language", *DergiPark-Sakarya University Volume 7, Issue 2*, 15.11.2020
- Dardane Bojaxhi „Theoretical overview of the structure and development of collocations”, *DergiPark-Sakarya University Volume 8, Issue 1*, 28.02.2021

Po ashtu ajo ka botuar tekstin universitar: *Der Einsatz von Film im DaF-Unterricht*, Libri shkollor, Prishtinë 2015.

Kandidatja Dardane Bojaxhi, nga viti 2014 është e angazhuar si asistente në programin studimor Gjuhë dhe letërsi gjermane në Universitetin e Prizrenit, Republika e Kosovës.

Vlerësimi i tezës së doktoraturës së kandidates, znj. Dardane Bojaxhi

Teza e doktoraturës e kandidates, znj. Dardane Bojaxhi i plotëson si kushtet formale-juridike në bazë të Rregullores së studimeve të doktoraturës të Fakultetit Filologjik të Universitetit të Tetovës, po ashtu edhe ato përbajtësore. Ajo është e shkruar në 130 faqe, me një rrjedhshmëri gjuhësore dhe stilistikore në nivelin e duhur, strukturimi i krerëve është i qartë dhe zhvillohet në dy linja: teorike dhe empirike, kurse burimet janë në numër të madh dhe dëshmojnë për autencitetin e hulumtimit në fjalë, që nënkupton se kandidatja ka dëshmuar për një pjekuri hulumtuese-shkencore. Po ashtu, punimi nuk përban elemente të plagiaturës, verifikuar edhe në sistemin për plagiaturë të MASH-it të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Tematika në fjalë është e një rëndësie të veçanti në fushën e frazeologjisë në përgjithësi, e sidomos në prirjen e re nocionore në gjuhësinë shqiptare, duke pasur parasysh traditën tonë gjuhësore, që ende është e ngulitur në tradicionalizmin. Teksa në gjuhësinë shqiptare kemi një mbinacion frazeologji, gjuhësia gjermane tashmë një kohë të gjatë i ka kategorizuar njësitë frazeologjike dhe, së fundmi, ka hyrë edhe nocioni kolokacion, që shpreh njësi të

ngurtësuara, por pa një kuptim të nëntëshëm në vete dhe, kryesisht, ato janë ndërtime më shumë gramatikore se sa semantike.

Me këtë rast, kandidatja ia ka dalë me sukses ta shtjellojë temën e doktoraturës në fjalë, duke iu qasur me një mprehtësi shkencore tematikës, sidomos aspektit kontrastiv të kolokacioneve në gjuhën gjermane dhe në gjuhën shqipe, për t'i dhënë shkencës së gjuhës në përgjithësi, sidomos fushës së frazeologjisë një fjalorth solid të kolokacioneve në të dxja gjuhët.

Në kreun hyrës janë formuluar mjaft qartë hapat e ndërmarra për realizimin me sukses të këtij punimi të doktoraturës.

Qysh në fillim të punimit jepet një arsyetim i duhur i temës:

Gjuhëtarët qysh në kohët e hershme kanë vërejtur që fjalët, në marrëdhënie me njëra-tjetrën, shpesh janë të zgjedhura (kanë lidhje fikse). Këto lidhje janë të analizuara mirë dhe nga kjo rezulton ky definicion për kolokacionet, të cilin e kam marrë nga fjalori DUDEN:

1. (veraltet) Anordnung der Reihenfolge [zu berücksichtigender Gläubiger]; Anweisung des Platzes
 1. (Sprachwissenschaft) inhaltliche Kombinierbarkeit sprachlicher Einheiten (z. B. *dick + Buch*, aber nicht: *dick + Haus*)
 2. (Sprachwissenschaft) Zusammenfall verschiedener Inhalte in einer lexikalischen Einheit (z. B. englisch *to swim* und *to float* in deutsch *schwimmen*)

Pikërisht ky fenomen paraqet sot një problem në mësimin e gjuhës së huaj, pasi këto lidhje fikse të fjalëve nuk janë të njëta në të gjitha gjuhët, mirëpo bartin karakteristikat e gjuhëve, shpesh edhe implikatura të veçanta kulturore. Prandaj edhe duhet pasur shumë kujdes fillimi shtëpiake të kuptuarit e tyre dhe më pas, edhe në përdorimin e përshtasthëm të tyre në kontekste të ndryshme. Nuk mjafton të dish kuptimin e secilës fjalë që ta flasësh e ta kuptosh mirë një gjuhë. Mësimi i gjuhës kërkon njoħuri të mira të pajtueshmërisë/përputhshmërisë mes fjalëve. Gjatë mësimit të gjuhës së huaj patjetër që do të haset edhe në kolokacione, të cilat mund të barazohen me **idiomat**, **frazemat** ose **njësitë frazeologjike**. Ato mund të trajtohen në aspektin semantik (si njësi idiomatike ose semi-idiomatike) dhe në aspektin e përputhshmërisë leksikore-semantike.

Në 50 vitet e fundit kolokacionet/lokucionet si objekt hulumtimi gjuhësor, para së gjithash në vendet gjermanishtfolëse, kanë marrë vëmendje të veçantë. Termi kolokacion/lokucion përdoret në mënyra të ndryshme dhe, për të përshkruar fenomene gjuhësore, të cilat luajnë rol të rëndësishëm në studimet sintagmatike të nivelit leksikor dhe kanë të bëjnë me llojet tipike të kombinimeve të elementeve të fjalorit. Në kuptimin e gjerë kolokacionet/lokucionet shihen si kombinime të fjalëve, të formuara në përputhshmëri sintaksore e semantike.

Në frazeologjinë europiane kolokacionet/lokucionet janë kombinime tipike, specifike dhe karakteristike të dy fjalëve (*Kollokationen sind normtypische phraseologische Wortverbindungen, die aus einer Basis und einem Kollokator bestehen*, khr. Hausmann 1985:118), të cilat jo gjithmonë mund të kenë sqarim semantik, p.sh. kombinimet frazeologjike *Bett* dhe *machen*, *Zähne* dhe *putzen*, *Tisch* dhe *decken* (Hausmann, po aty, fq. 311).

Njëra ndër vështirësitë më të mëdha në përcaktimin e kolokacioneve/lokucioneve kryesisht për gjuhët analitike, qëndron në caktimin e kufijve mes kolokacioneve/lokucioneve dhe kompozitave. Kriteret, të cilat janë propozuar për zgjidhjen e këtij problemi mund të ndahen përafërsisht në dy grupe (Gross 1988): **kriteret semantike** (Darmstetter 1874-1967) dhe **kriteret formale** (Mitterand 1976).

Bazuar në këto që u cekën më sipër, do të përpiqem të merrem me këtë dukuri gjuhësore në përgasjen shqip-gjermanisht, nisur nga kjo problematikë komplekse me të cilën jam ndeshur si në mësimdhënëse e gjuhës gjermane, po ashtu edhe gjatë aktivitetit tim përkthimor.

Edhe qëllimet e punimit janë të shtruara qartësisht:

Nisur nga fakti që kjo dukuri është komplekse dhe haset në gjuhën e përditshme, pra në mësimin e gjuhës së huaj, duhet si fillim që kolokacionet/lokucionet të kuptohen dhe më pas të përdoren saktë. Me këtë studim dua t'u vij, sado pak, në ndihmë nxënësve, studentëve dhe personave tjera që duan ta mësojnë gjuhën gjermane.

Këtë mendoj ta arrij përmes analizës së formimit të kolokacioneve/lokucioneve në të dyja gjuhët dhe problematikës përkthimore, për të cilën, bazuar në veprën e Stefan Zweig *Brief einer Unbekannten* të shkruar në gjuhën gjermane dhe të përkthyer në gjuhën shqipe, do të gjej kolokacionet/lokucionet në të dyja gjuhët dhe do të bëj analizë përkthimore dhe do të gjej ngjashmëritë ose ndryshimet në strukturë dhe formim. Pra, këtu do të trajtohet aspekti sintaksor, morfologjik dhe semantik. Studimi ka për bazë analizën e kolokacioneve/lokucioneve në të dyja gjuhët në tre aspekte, si dhe analizën kontrastive të

tyre. Kjo do të jetë diçka e re në gjuhësinë shqiptare, pasi që studimet në këtë lëmi mungojnë dukshëm dhe ky do të ishte një kontribut fillestar për gjuhësinë dhe për personat që duan ta mësojnë gjuhën gjermane në përgjithësi, madje ky studim do të jetë ndihmë tejet e madhe edhe për përkthyesit. pasi që bashkangjitur këtij studimi do të jetë edhe një fjalor i kolokacioneve/lokucioneve, ku do të paraqiten kolokacione/lokucioneve në gjuhën gjermane dhe përkthimi ekvivalent në gjuhën shqipe.

Evident është edhe korpusi i dendur metodologjik, i cili konsiston në metodat e përdorura si në vijim:

Për pjesën teorike do të përdoret metoda e deduksionit, e cila përfaqëson një metodë studimi e arsyetimi që niset nga teza, ideja ose konkluzioni i përgjithshëm dhe nxjerr prej tyre ëde dhe konkluzione të veçanta. Pra ky term ka të bëjë me një përfundim të nxjerrë nga një mendim i përgjithshëm. Kjo metodë përdoret atëherë kur është grumbulluar dhe përpunuar material i pasur faktik, prej të cilët nxirren konkluzione të veçanta. Kjo është metoda më e përshtatshme për pjesën teorike të këtij studimi, mirëpo edhe metoda historike do të vlejë, pasi që ky studim bazohet në hulumtime të hershme. Gjithashtu do të përdoret metoda e krahasimit, e cila ka rëndësi të veçante për një studim të këtij lloji.

Ndërsa pjesa praktike do të bëhet me metodën analizë-sintezë, pasi që u cek më sipër që do të analizohet një vepër. Ndërsa për punën e anketimit me nxënës e studentë do të përdoret metoda sasiore-cilësore, metodë klasike e të cilës është anketimi.

Korpusi është i menduar në mënyrë adekuatë:

I gjithë punimi do të bazohet në pjesën teorike, tek e cila do të hyjnë studimet e deritanishme në fushën e leksikologjisë dhe kolokacioneve/lokucioneve, studimet e bëra në gjuhën gjermane dhe shqipe dhe do të jepen edhe sqarime për dallimin e kolokacioneve/lokucioneve nga idiomat ose shprehjet frazeologjike, pasi që të gjitha janë shumë të përaferta me njëratjetërin dhe mund të shpien edhe në ngatërrim të termeve. Mendohet që pjesa teorike të bëhet në një kapitull, tek i cili do të ketë ndarje përmes nënkapitujve dhe kështu qasja në vështrimin e kolokacioneve/lokucioneve do të jetë e klasifikuar mirë.

Pjesa praktike, e cila do të përfshijë të gjithë pjesën tjetër të punimit, do të përfshijë analizën e kolokacioneve/lokucioneve bazuar në veprën e Zweig.

Me kolokacionet/lokucionet e nxjerra nga kjo vepër në të dyja gjuhët do të bëhet analizë në të tri rrafshet: sintaksore, morfologjike dhe semantike. Më pas është menduar të bëhet një anketim (pjesa empirike) me studentë, i cili synon të nxjerrë vështirësitë gjatë përkthimit të kolokacioneve apo eventualisht edhe ndonjë përkthim më të përshtatshëm të ndonjë kolokacioni. Këtu pyetja mbetet e hapur, pasi që rezultati mund të nxjerr diçka të re.

Kandidatja ka konsultuar dhe cituar rajone relevantë vendorë, rajone dhe gjermanë, si Eqrem Çabej, Shezai Rrokaj, Shaban Demiraj, Emil Lafe, Berton Sulejmani, Arbër Çeliku, Kolec Topalli, Wilhelm Fiedler, Gustav Majer, Norbert Jokli, Robert Elsi, Armin Hetcer, Oda Buholc, etj., por edhe punimet e konferencave të përmbledhura nga Akademia e Shkencave të Kosovës lidhur me etnogjenezën e gjuhës shqipe, të Institutit Albanologjik të Prishtinës, ka cituar edhe dokumente arkivore, si dhe ka realizuar 3 intervista të autorëve, që merren me tashmë gjatë kohë me këtë problematikë si Shezai Rrokaj, Ajtene Hajdari-Qamili dhe Joachim Matzinger, bashkëpunëtor i Akademisë së Shkencave Austriake, që tashmë po punon në fthimin e autoktonisë së plotë të shqipes në kuadër të Akademisë së Shkencave Austriake.

Punimi është i struktura në këtë mënyrë:

Ai ka shtatë kapituj, përfundimin dhe bibliografinë.

Ky punim doktorature, përveç kapitullit hyrës, ku jepet qëllimi i punimit dhe metodologjia e punës shkencore, përmban 3 kapituj kryesorë dhe një kapitull përmbyllës si dhe një bibliografinë e nevojshme.

Kapitulli i dytë duhet kuptuar si një kapitull teorik, në të cilin jepet një historik i shkurtër i zhvillimit të frazeologjizmave, po ashtu sqarohet nocioni frazeologjizëm në kuptimin e gjerë dhe atë të ngushtë.

Kapitulli i tretë trajton nocionin ‘kolokacion’, historikun e zhvillimit të tij si dhe përdorimin e tij në gjuhësinë gjermane. Me rëndësi është të përmendet me këtë rast, se nocioni ‘kolokacion’, siç dhe përshkruhet në këtë kapitull, është kthyer tashmë si një disciplinë e specializuar në gjuhësinë gjermane.

Kapitulli i katërt i qaseta nocionit ‘kolokacion’ në gjuhësinë shqiptare, duke qenë ky punim i pari, i cili po mëton ta fusë një nocion të tillë. Duke shfletuar punimet e Thomait dhe

frazeologëve të tjerë shqiptar, duhet thënë se frazeologjia shqiptare ende është e ngulitur thellë në tradicionalizmin gjuhësor dhe, si rrjedhjo, për nacionin ‘kolokacion’ përdoren termi ‘lokucion’, por që, në aspektin kuptimor dhe funksional, këto nocione nuk janë plotësisht sinonimike.

Kapitulli i pestë trajton kolokacionet nga një vështrim i pastër teorik, duke analizuar strukturën e ndërtimit të tyre gramatikor, aspektin e tyre funksional dhe kuptimor.

Kapitulli i gjashtë përbën një analizë të ‘kolokacioneve’ të novelës së Zweig-ut Letra e një të panjohure, me ç'rast janë analizuar në rrafshin morfollogjik dhe sintaksor kolokacionet e gjetura në këtë novelë.

Kapitulli i shtatë përmban një fjalorth të kolokacioneve me një përqasje krahasuese gjermanisht-shqip, me synimin që të gjithë ata, të cilët e mësojnë gjermanishten si gjuhë të huaj, ta kenë më të lehtë t'i gjejnë, përdorin dhe deshifrojnë kolokacionet në mësimin e gjermanishtes.

Përfundim:

Duke marrë parasysh të gjithë këto parametra, ne, në cilësinë e komisionit vlerësues, konstatojmë se punimi i doktoraturës me temë: *Kolokacionet në gjuhën gjermane dhe shqipe – analizë kontrastive*, i kandidates, znj. Dardane Bojaxhi i plotëson të gjitha kriteret e duhura hulumtuese-shkencore.

Rezultatet e arritura janë të kënaqshme dhe sjellin risi të dukshme në korpusin e tërësishëm shkencor lidhur me kolokacionet në gjuhën gjermane dhe shqipe dhe punimi i pasuron shkencat albanologjike me një punë serioze për një çështje kaq të rëndësishme, që varion sa i përket çështjes nocionore nga gjuha gjermane në atë shqipe.

Prandaj dhe njëzëri japim **vlerësimin tonë pozitiv** lidhur me punimin e doktoraturës në fjalë.

PROPOZIM

Në cilësinë e anëtarëve të komisionit, ne e falënderojmë Këshillim mësimor-shkencor të Fakultetit filologjik për besimin e dhënë për vlerësimin e disertacionit të doktoraturës të kandidates Dardane Bojaxhi me temë: *Kolokacionet në gjuhën gjermane dhe shqipe – analizë kontrastive* dhe njëzëri i propozojmë Këshillit mësimor-shkencor respektiv, që ta miratojë vlerësimin tonë pozitiv lidhur me këtë punim doktorature dhe të vazhdojë me procedurën e mëtejshme deri në mbrojtjen publike të këtij punimi të doktoraturës.

Tetovë, më 01.02.2024

Komisioni vlerësues

1. Prof. Dr. Gjuliano Iseini – kryetar

2. Prof. Dr. Majlinda Nuhiu – anëtar

3. Prof. Dr. Arbër Çeliku – anëtar

4. Prof. Dr. Beriton Sulejmani - anëtar

5. Prof. Dr. Shadan Ramadani – anëtar